

FORMULARI NUMËR 3

KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Emri:	Arben
Mbiemri:	Kadriu

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni si vijon:

I. Analizën tuaj:

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?

Prokuroria e shtetit ka arritur sukses të dukshëm në përmbushjen e obligimeve, kushtetuese dhe ligjore duke u bazuar në pavarësi, paanësi, integritet, llogaridhënie, efikasitet, transparencë dhe profesionalizëm.

Nga raporti i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2023, shihet se Prokurori i Shtetit, gjatë kësaj periudhe raportuese ka zgjidhur 10,120 kallëzime penale më pak se që janë pranuar, e shprehur në përqindje 19.42% kallëzime – lëndë. Konsideroj që me rritjen e numrit të prokurorëve, stafit mbështetës – bashkëpunëtorëve profesional, me menaxhim adekuat mund të ndryshohet kjo gjendje, ashtu që të zgjidhen kallëzime – lëndë më shumë se që pranohen dhe në këtë mënyrë do të zvogëlohet numri i lëndëve në pritje.

Në sistemin gjyqësor, numri i gjyqtarëve është gjithnjë në rritje, njëkohësisht rritet edhe numri i seancave gjyqësore, çka kërkon edhe angazhim të shtuar të prokurorëve. Është e nevojshme të vazhdohet me trajnimin e prokurorëve dhe në përdorimin e teknologjisë për të përmirësuar proceset e hetimit dhe ndjekjes penale, e që kjo do të kontribuojë në një sistem të drejtësisë më të fortë dhe më të besueshëm. Konsideroj që me aplikimin e Planit të punës së Prokurorit të Shtetit dhe Planit Strategjik, do të arrihet që të tejkalohet çdo sfidë dhe do të ketë rezultate më të larta.

2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në prokurorinë për të cilën keni aplikuar?

Prokuroria Themelore në Gjiilan, para vitit 2021, ka funksionuar me 17 prokuror dhe nga viti 2021, ka pasur zvogëlim të numrit të prokurorëve për arsye të ndryshme, dhe gjendja më kritike ka qenë në vitet 2023-2024, kur Prokuroria Themelore në Gjiilan, ka funksionuar me vetëm 10 prokuror, të cilët kanë përfaqësuar në Gjykatën Themelore në Gjiilan dhe tri degët e saj – Viti, Kamenicë dhe Novobërdë.

Përkundër numrit të vogël të prokurorëve, kjo prokurori ka pasur rezultat shumë të mirë të punës dhe gjatë viteve numri i lëndëve të bartura nga vitet paraprake ka qenë i vogël. Në regjistrat PPI, PPII dhe PPM:

- Gjatë vitit 2021 janë pranuar 2515 kallëzime penale, janë zgjidhur 2518 dhe në fundvit kanë mbetur të pazgjidhura 98 lëndë.
- Gjatë vitit 2022 janë pranuar 2745 kallëzime penale, janë zgjidhur 2773 dhe në fundvit kanë mbetur të pazgjidhura 70 lëndë.
- Gjatë vitit 2023 janë pranuar 2310 kallëzime penale, janë zgjidhur 2311 dhe në fundvit kanë mbetur të pazgjidhura 69 lëndë.

Përkundër që numri i prokurorëve nga 17 ka rënë në 10 prokurorë, rezultatet e punës kanë qenë të njëjta. Konsiderojmë që ky rezultat është arritur me menaxhim dhe punë të palodhshme të prokurorëve të kësaj prokurorie, vlen të ceket se në tre mujorshin e katërt të vitit 2022, norma orientuese në departament të përgjithshëm ka arritur deri në 172.75%. Pra, në Prokurorinë Themelore në Gjiilan nuk ka lëndë në pritje, nuk parashkruhen lëndët, përjashtimisht lëndëve me PPP (lëndë me kryerës të panjohur), të cilat janë trashëguar që nga viti 2000.

Sa i përket procedurave alternative të zgjidhjes së lëndëve duke i përfshirë edhe urdhrat ndëshkimorë, në vitin 2021 janë zgjidhur 12.23% e lëndëve, në vitin 2022, 25.13% dhe në vitin 2023 janë zgjidhur 45.26% e lëndëve, çka konsiderojmë se është arritur një sukses i lartë.

Raportet kolegjiale në mes prokurorëve dhe stafit administrativ janë të mira, ka bashkëpunim, përkundër sfidave që paraqitën rreth përfaqësimit të lëndëve në departamentin e krimeve të përgjithshme, me që numri i gjyqtareve penalistë është dukshëm më i madh se i prokurorëve. Përkundër numrit të vogël të prokurorëve, me menaxhim adekuat dhe raporte të mira kolegjiale, arrihet me sukses përfaqësimi i lëndëve në Gjykatën Themelore në Gjiilan, dhe degët e saja në Kamenicë, Viti dhe Novobërdë.

Me Gjykatën themelore në Gjiilan-Kryetarin e gjykatës, kemi takime të rregullta dhe kemi arritur marrëveshje që në departamentin e përgjithshëm, ditëve të hëna të caktohen vetëm lëndë urgjente me paraburgim dhe dita e premtë të jetë ditë pa

shqyrtime gjyqësore, ashtu që gjyqtarët ta shfrytëzojnë për përpilimin e aktgjykimeve, ndërsa prokurorët të ftojnë palë për intervista apo të hartojnë akte.

Me qëllim të punës sa më efikase dhe me kualitet të lartë, në koordinim me KPK-në, do të kërkojmë rekrutimin e prokurorëve dhe shtimin e stafit mbështetës, duke e bërë të mundur që secili prokuror të ketë nga një bashkëpunëtor profesional, po ashtu edhe shtimin e stafit tjetër mbështetës.

Nga fillimi mandatit tim 01.01.2021, deri tani janë paraqitur 15 ankesa kundër prokurorëve prej të cilave 14 janë hedhur si jo serioze dhe të pa bazuara, ndërsa është ushtruar vetëm se një kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore, e cila është aprovuar në KPK. Konsiderojë që takimet e rregullta me qytetarë të cilat i mbajmë çdo të hëne kanë ndikuar që numri i ankesave ndaj prokurorëve të jetë i ulët. Sa i përket stafit administrativ nuk është zhvilluar asnjë procedurë.

Sa i përket lëndëve me ndihmë juridike ndërkombëtare, të njëjtat janë trajtuar me prioritet, gjatë këtyre viteve nuk kemi pasur lëndë në pritje, pasi që të gjitha veprimet janë ndërmarrë në afat optimal. Lidhur me suksesin dhe bashkëpunimin kemi pranuar e-mail të datës 08.02.2024, nga drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar duke u falënderuar për bashkëpunimin, suksesin dhe efikasitetin, duke cekur se ky sukses kontribuon në sjelljen para drejtësisë të kriminelëve të shpallur në kërkim ndërkombëtar në Interpol, e që sipas tij i kemi dhënë imazh shumë të mirë para shteteve të fuqishme të BE-së, regjionit etj.

3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?

Sfidë kryesore në këtë prokurori ka qenë numri i vogël i prokurorëve dhe nga kjo janë paraqitur sfida në përfaqësimin në Gjykatën Themelore në Gjiilan dhe tri degët e saj, pasi që numri i gjyqtarëve penalist ka qenë më i madh dhe gjithnjë në rritje.

Përkundër rezultateve e vlerësojmë të nevojshme rritjen e profesionalizimit të punës së prokurorëve, e cila do të arrihet përmes trajnimeve të vazhdueshme, me qëllim të funksionimit edhe më efikas, avancimit dhe profesionalizimit të punës së Prokurorit të Shtetit.

Sfidë është bashkëpunimi me Institutin e mjekësisë ligjore, për shkak të vonesave të raporteve të autopsisë. Bashkëpunimi me Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, për shkak të vonesave të ekzaminimit të narkotikëve, ekzaminimit balistik të armëve, ekzaminimit të pajisjeve elektronike, ekzaminimit të analizave të ADN-së dhe serologjike etj. Po ashtu bashkëpunimi me Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, e cila është në mungesë të kapaciteteve dhe ka vonesa rreth ekzaminimit të

personave me çrregullime mendore në këtë institut. Të gjitha këto ndikojnë në efikasitetin dhe ekonomizimin e procedurës penale.

Duhet të vazhdohet trajtimi me prioritet të veprave penale të dhunës në familje, veprat penale kundër integritetit seksual, krimeve ekonomike, korrupsionit dhe trafikimit me qenie njerëzore.

Sfidë tjetër mbeten edhe veprat penale të krimeve ndërkufitare siç është edhe kontrabandimi me emigrantë, kontrabandimi me mallra, duke marrë parasysh se regjioni ynë ka një vijë të gjatë kufitare këto vepra penale janë më të shpeshta.

Një tjetër sfidë është edhe përmirësimi i përdorimit të sistemit SMIL nga ana e prokurorëve dhe stafit si dhe harmonizimi i raporteve fizike me atë të sistemit.

Një nga sfidat është numri relativisht i madh i lëndëve PPP (kallëzime penale me persona të panjohur), të cilat janë trashëguar që nga viti 2000, ku një numër i tyre ka mbetur ende pa përfunduar, përkundër faktit që përmes urgjencave kërkohet nga policia që kryerësit të zbulohen.

4. A mendoni se strategjitë aktuale të sistemit adresojnë nevojat e prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

Prokuroria Themelore në Gjiilan, duke punuar në harmoni me planin e punës dhe me politikën që dalin nga KPK, ka arritur të përmbushë me sukses detyrat dhe përgjegjësitë. Në vazhdimësi do të punojmë në pajtim me rregulloret, vendimet, strategjitë dhe planet e punës që dalin nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Gjatë vitit po ashtu zbatohet edhe plani vjetor i hartuar në fillim të vitit me qëllim të arritjes së objektivave, e të cilat plane hartohen në harmoni të plotë me strategjitë e udhëhequra nga KPK dhe ZKPSH.

Një nga strategjitë aktuale është monitorimi i punës së prokurorëve. Prokurorët kujdestarë përpilojnë raporte ditore rreth ngjarjeve gjatë 24 orëve, po ashtu edhe nga policia e Kosovës, kryeprokurori pranon e-mail për të gjitha ngjarjet ditore çka ofron mundësi që të monitorohet puna e tyre. Në kolegjiunet të cilat mbahen çdo të hënë prokurorët kujdestarë raportojnë për punët e tyre javore.

Sa i përket trajtimit efikas të lëndëve në çdo fund të muajit, administrata përpilon raporte për të gjithë prokurorët se sa lëndë kanë pranuar, sa lëndë kanë zgjidhur dhe sa lëndë janë bartur. Kjo është një metodë që përcjellët efikasiteti dhe arritja e normave orientuese e prokurorëve.

Bashkëpunimi me institucione-kontaktet e shpeshta me eprorët e Policisë së Kosovës, rrisin bashkëpunimin dhe po ashtu shkëmbehen informata, ide, strategji për punën e përbashkët.

Në kuadër të strategjisë për trajtimin me prioritet të rasteve të dhunës në familje mbahen takime me akterët-Policinë e Kosovës, Zyra për Mbrojtën e Viktimave, përfaqësues të Strehimores, si dhe përfaqësues të Qendrës për Punë Sociale, me qëllim të hetimit me prioritet të rasteve të dhunës në familje si dhe ofrimit koordinimit për ofrimin e ndihmës viktimave. Konsiderojmë se zbatimi i strategjive ka rezultuar me një sukses të lartë të prokurorisë në përgjithësi për çka tregojnë edhe raportet e punës.

II. Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në prokurorinë që keni aplikuar?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?

Për të përmirësuar punën operative ne Prokurorinë Themelore në Gjilan, do të vazhdojmë fillimisht me rritjen e komunikimit në mes të Prokurorisë, Policisë, Administratës Tatimore, Institutin e Mjekësisë Ligjore, Doganës së Kosovës, Agjencisë të Kosovës për Forenzikë dhe institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit. Përkundër takimeve në baza ditore me hetues nga Policia e Kosovës do të vazhdojmë të mbajmë takime të përbashkëta me udhëheqës nga Policia e Kosovës, me drejtorin regional, komandantët e shtatë stacioneve policore dhe me shefat e hetimeve, me qëllim të rritjes së bashkëpunimit dhe luftimit efikas të kriminalitetit në përgjithësi.

Gjatë këtyre 4 viteve kemi avancuar dukshëm në hapjen ndaj publikut, duke mbajtur kontakte me media përmes raporteve ditore dhe komunikatave, të cilat disa media lokale edhe i publikojnë në baza ditore. Konsiderojmë që kjo ka ndikuar që publiku të informohet për punën e prokurorisë në mënyrë të drejtë. Zyra për informim në kuadër të prokurorisë, tani ka qasje në publikimin në rrjetin social-facebook të sistemit prokurorial të raporteve dhe komunikatave, njoftimeve dhe sqarimeve. Do të përpiqemi që edhe më shumë që në të ardhmen të rritet çdo ditë e më shumë besimi i qytetarëve në sistemin prokurorial.

2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?

Objektivë kryesore është që institucioni i prokurorisë duhet të rrisë besimin e publikut. Me rritjen e besimit të publikut në sistem prokurorial, prokurorët do të ndihen më të sigurve në punën e tyre, do të kenë autoritet dhe kredibilitet më të lartë.

Objektivë tjetër ka qenë dhe mbetet ndjekja penale, zhvillimi i hetimeve, ngritja e akteve akuzuese, përfaqësimi në gjykatë në mënyrë profesionale, të pavarur dhe të paanshëm, duke garantuar siguri që të gjitha palët të trajtohen në mënyrë të barabartë, pa dallim gjinisë racës, prejardhjes kombëtare, sociale bindjeve politike, besimit fetar, e cila do të arrihet përmes llogaridhënies së prokurorëve, por edhe stafit administrativ, motivimit, pastaj udhëzimeve të vazhdueshme në respektimin e afateve kohore, bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet eprorit dhe vartësve të tij, ruajtja dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet tjera si Policinë, Inspektoratin Policor të Kosovës, Doganën e Kosovës, ATK etj.

- Llogaridhënia dhe profesionalizmi

Llogaridhënia në Prokurori, obligon prokurorët të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre, përfshirë zbulimin e veprave penale, identifikimin e kryerësve, ndjekjen ose mbylljen e rasteve dhe mënyrën se si trajtohen ato. Llogaridhënia kërkon vendimmarrje të bazuara në ligji, të arsyetuara mirë, raportim të punës dhe përmbushjen e detyrave, kontroll të brendshëm, dhe respektim të afateve ligjore.

3. Cilat janë sfidat që prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektiveve?

Është e kuptueshme se gjatë përmbushjes së objektiveve të lartshënuara do të kemi edhe sfida të natyrave të ndryshme e ndër të cilat mund të jenë rastet tek të cilat kemi sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë, ngaqë deri më tani nuk kemi ndonjë praktikë unike, andaj dhe trajnimi i prokurorëve në këtë drejtim është më së i nevojshëm, pastaj kur kemi të bëjmë me rastet e krimeve kibernetike, po ashtu një tjetër nevojë është që duhet të trajnohen prokurorët nga personat të specializuar në këtë drejtim, po ashtu edhe ndryshimet e shpeshta në legjislacionin penal, sfidë tjetër do të kemi edhe plotësimin e numrit të prokurorëve dhe stafit tjetër administrativ.

4. Si do t'i tejkalonit ato?

Do të punohet në tejkalimin e sfidave në koordinim të plotë me Këshillin Prokurorial dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. Do të vazhdojmë që të kërkojmë dhe ti motivojmë prokurorët që ta rrisim numrin e zgjidhjes së lëndëve me procedurë alternative të cilat zgjidhje do të ndihmonin në efikasitetin dhe ekonomizimin e procedurave, në këtë mënyrë do të zvogëlohet numri i përfaqësimit i lëndëve në gjykatë.

III. Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial

Ju lutem renditni hapat konkretë që do t'i ndërmerrnit gjatë mandatit tuaj:

1. Cili është modeli juaj në menaxhimin e stafit?

Modeli im në menaxhimin e stafit përfshin disa aspekte kyçe:

- **Komunikimi i hapur:** Inkurajimi i një kulture komunikimi të hapur ku anëtarët e stafit ndihen të lirë të shprehin ide, shqetësime dhe sugjerime.
- **Trajnimi dhe zhvillimi:** Ofrimi i mundësive për trajnim dhe zhvillim profesional për të ndihmuar stafin të përmirësojnë aftësitë e tyre dhe të zhvillohen në karrierë.

Në bashkëpunim me Administratorin do të kërkohet llogaridhënie nga stafi administrativ përmes raporteve javore, ashtu që ngarkesat në punë brenda administratës të jenë proporcionalisht të ndara. Planifikohet të mbahen takimet e rregullta me administratorin dhe me stafin ashtu që të përcillen sukseset, vërejtjet dhe sugjerimet me qëllim të përmirësimit dhe ngritjes së rezultateve të punës.

2. Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin?

Ndarja e lëndëve behët përmes sistemit elektronik të menaxhimit të lëndëve SMIL, përjashtimisht lëndët me masë për prezencën e të pandehurve në procedurë, të cilat ndahen tek prokurorët që janë kujdestarë. Punët tjera administrative do të ndahen në mënyrë proporcionale ashtu që mos të ketë diferenca me ngarkesa në punë.

3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?

Në bashkëpunim me administratorin do të mbahen takime të rregullta me të gjithë stafin e prokurorisë, me qëllim të rritjes së llogaridhënies. Nga stafi administrativ do të kërkohen raporte javore, me qëllim të monitorimit të punës, ndarjes së barabartë të punëve, ashtu që punëtorët të ndjehen të barabartë dhe ti kryejnë me sukses obligimet e tyre.

IV. Hapat që do të ndërmerrni për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënies së sistemit, prokurorisë dhe besimit të publikut?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Çfarë hapash do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj, duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?

Transparenca është kusht thelbësor për të siguruar besimin e publikut dhe për të garantuar publikun se sistemi prokurorial funksionon në mënyrë të drejtë dhe të pavarur. Kjo do të arrihet me publikimin e informacioneve të qarta në kohë reale për punët konkrete të cilat kryhen në prokurori. Do të vazhdojmë të bëjmë publikime të shpeshta të njoftimeve për vendime-aktakuza, të cilat mund të jenë me interes për publikun, duke publikuar edhe raportet javore, mujore dhe vjetore. Po ashtu do të vazhdojmë që të jemi të hapur me mediat duke iu përgjigjur kërkesave për informata, përmes e-mailit zyrtar të prokurorisë. Gjatë transparencës do të ruajmë privatësinë dhe të drejtat e personave të përfshirë duke mos rrezikuar procedurat hetimore, por gjithmonë deri në atë masë që të ruajmë konfidencialitetin e procedurës.

Në transparencë, rëndësi ka edhe pritja e palëve nga kryeprokurori dhe do të vazhdojmë që çdo të hëne të jetë ditë kur çdo qytetar-palë të interesuara, të priten në zyrë dhe të ju jepen informacionet e kërkuara.

2. Cilat janë planet tuaja për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?

Duhet të krijohen kushte dhe të motivohen prokurorët që të ndjekin trajnimet, të vazhdohet të diskutohet në kolegji i cili do të vazhdon të mbahet çdo të hëne ashtu që të diskutohet për dilemat që prokurorët hasin gjatë punëve të tyre të përditshme. Inkurajohen prokurorët që gjatë punës së tyre konform Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të trajtojnë palët me dinjitet, brenda një intervali kohor të arsyeshëm.

Mekanizmi i vlerësimit luan rol të rëndësishëm për një punë cilësore, si dhe prokurorët të punojnë në mënyrë të pavarur, të pa anshme duke e zbatuar kodin etik për prokurorë.

3. Cilat janë planet tuaja për përmirësimin e llogaridhënies së përgjithshme në Prokurorinë tuaj?

Të gjithë prokurorët përpilojnë raporte dhe administrata e përgatitë raporte mujore, gjithëpërfshirëse me të cilat raporte rritet llogaridhënia e përgjithshme, mundësohet vlerësimi sasior dhe niveli profesional i punës. Rol vendimtar në rritjen e llogaridhënies është edhe vlerësimi i performancës së prokurorëve në bazë të raporteve dhe burimeve të informacioneve.

Konceptdokumenti nuk duhet të përmbajë më shumë sesa 10 faqe me shkrimin e llojit Book Antiqua, madhësia 12, hapësira njëshe.

Deklaroj se përmbajtjen e këtij konceptdokumenti e kam përgatitur vetë dhe jam në dijeni se i njëjti do të publikohet në uebportal.

Nënshkrimi: _____

Datë: _____

07.11.2024